



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 10.07. 2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Muharrem Nitaj, Xhelal Sveçla, Fadil Beka, anëtarë.

**Munguan:** Ramiz Kelmendi, Aida Dërguti, Ismet Beqiri dhe Bahrim Shabani.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

Çështjet vijuese.

***Kryetari i komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

**Kryetari**, lidhur me çështjet për të cilat është thirrur kjo mbledhje, theksoi se nga takimi që ka pasur me Kryetarin e Kuvendit është kërkuar që të gjitha projektligjet që ndërlidhen me agjendën evropiane të procedohen sa më shpejt, por duke qenë se në komision nuk ka të tillë, kërkoi që puna e grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, të përmbyllet. Po ashtu theksoi se në një artikull që është botuar në portalin “Koha.net” lidhur me të gjeturat gjatë mbikëqyrjes së Ligjit të IPK-së, theksoi se duhet të ketë kujdes secili anëtar që mos të paraqet qëndrimin e Komisionit pa mbaruar procesi i mbikëqyrjes dhe votimi i raportit me rekomandime në Komision.

**Rexhep Selimi** theksoi sa i përket punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, është bërë një punë e mirë dhe janë dëgjuar në grup punues mbi njëzet zyrtarë. Po ashtu theksoi e përgjatë kësaj kohe ka ndodhur edhe shkarkimi i kryeshefit të IPK-së, për këtë arsye e konsideroi i që puna e grupit punues duhet të vazhdojë edhe për pak kohë. Ndërsa sa i përket deklarimeve në media, theksoi se ka deklaruar të njëjta gjëra sikurse edhe në seancën e Kuvendit sa i përket zhvillimeve në IPK. Ndërsa theksoi që nëse kërkohet nga komisioni që të përmbyllet puna e grupit punues, kjo mund të bëhet, por që e vlerësoi të nevojshme që një punë e bërë me shumë përkushtim, nuk duhet përmbyllur me nguti.

**Muharrem Nitaj**, lidhur me punën e grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, theksoi se është bërë një punë e mirë dhe se janë intervistuar shumë zyrtarë, po ashtu propozoi që materialet dhe të gjeturat të ndahen me gjithë komisionin.

**Fatmir Xhelili** theksoi se grupi punues ka mundur të përfundojë punë javën e kaluar, por është sugjeruar nga kryetari që për shkak të procesit të anëtarësimit në INTERPOL të Kosovës, të shtyhet për më vonë. Po ashtu theksoi e të gjeturat e grupit punues gjatë procesit të mbikëqyrjes mund të ndikojnë në ndalimin e zhvillimit të disa dukurive qoftë në IPK apo në Policinë e Kosovës. Po ashtu theksoi se ri-organizimi i strukturës që është bërë në kuadër të IPK-së, ka qenë jo ligjore dhe ka pasur tendenca për ndryshimin e gjithë strukturës, ku janë bërë ndryshimet edhe të pozitave të drejtorëve që kanë pasur aktrim dhe i kanë bërë me afate kohore me mandat. Po ashtu theksoi se lidhshmëria e zyrtarëve të IPK-së me Policinë e Kosovës nuk duhet të zgjatë në momentin e punësimit në IPK. Ndërsa sa i përket deklarimeve në media, theksoi që disa deklarata të deputetëve, por edhe analistëve janë duke dëmtuar në proces të dialogut me shtetin serb, të tilla kanë qenë deklaratat lidhur me transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura, ku pati një lloj ndikimi edhe me largimin e disa pjesëtarëve të komunitetit serb nga FSK-ja, duke mos përjashtuar edhe presionin nga grupet mafioze. Për këtë arsye theksoi që nëse deklaratat të ishin të matura pa tentuar të jepet ngjyrë patriotike do të kishte më shumë sukses, po ashtu shtoi se nuk e konsideron të ngutshme përfundimin e raportit për mbikëqyrjen e ligjit të IPK-së duke e lënë të miratohet për në sesionin vjeshtor.

**Xhelal Sveça**, duke iu referuar punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, shtoi se përgjatë punës janë gjetur disa shkelje dhe propozoi që në raste të tilla, është mirë që t’u drejtohet letër titullarëve të institucionit ose institucionit që i raportojnë për t’ua bërë të ditur shkeljet. Po ashtu theksoi se gjatë punës së grupit punues ka pasur tendenca për të penguar punën e grupit punues.

**Rexhep Selimi**, lidhur me punën e grupit punues, theksoi se është dilema se kur është më e përshtatshme të votohet raporti dhe cili do të jetë efekti i këtij raporti me rekomandime duke

shtuar se do të ishte mirë sikur raportin me të gjetura të kenë në dispozicion institucioni që do të përzgjedh kryeshefin e ri, pro që nuk mund të ndahet pasi akoma nuk është votuar në komision, duke shtuar që pjesa e parë e shtatorit do të jetë koha kur do të votohet raporti me rekomandime. Ndërsa sa i përket asaj se deklaratimet për disa raste ku është shkelur ligji dhe janë gjetur parregullsi, theksoi se nuk e pengojnë procesin e anëtarësimit në INTERPOL, pasi kjo punë është në të mirë të institucionit.

**Kryetari** theksoi se është e rëndësishme të mos bëhen deklaratime në emër të komisionit pa përfunduar puna e grupit punues.

**Rexhep Selimi** theksoi se deklaratime më të ndjeshme janë ato që bëhen lidhur me transformimin e FSK-së, pasi deklaratime të tilla po dëmtojnë këtë proces. Ndërsa takimin e sotëm e konsideroi si të dobishëm për të diskutuar lidhur me punët vijuese. Ndërsa sa i përket raportit për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, theksoi se duhet të shikohet mundësia nëse mundet që konkursi për kryeshef të IPK-së të shtyhet deri sa të votohet raporti me rekomandime, duke e konsideruar si të dobishme marrjen në konsideratë të rekomandimeve.

**Muharrem Nitaj**, lidhur me diskutimin për shtyrjen e konkursit, theksoi se komisioni nuk mund të ndikojë, por mund të përcjellë disa të gjetura për t'u informuar ministria para se të përzgjidhet kryeshefi i IPK-së.

**Fatmir Xhelili** theksoi se nuk e konsideron ndërhyrje nëse do të shkruhej një letër dhe t'i drejtohej Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, në mënyrë që të njoftohen lidhur me zhvillimet e deritanishme në IPK.

**Kryetari** theksoi se e konsideron si pozitive dakordimin për dërgimin e një letre, për të njoftuar Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Kryeministrin lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet pozitive përgjatë procesit të zgjedhjes së kryeshefit të IPK-së.

**Kryetari**, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**